



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 12 nëntor 2018.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10. 03. 2005 "Për ndihmën dhe shërbimet Shoqërore", të ndryshuar".(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla Nuri Belba dhe Klotilda Bushka.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Bardh Spahia, Floida Kërpaçi dhe Grida Shqina.

Të ftuar:

Vullnet Sinaj – deputet, nismëtar i projektligjit
Ardiana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Denada Seferi - Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Eneida Çapo- Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Miranda Pashaj – Përfaqësuese nga Shërbimi Social Shtetëror.

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë.

Në rend dite kemi miratimin e procesverbalit të datës 12. 11. 2018. Besoj se jeni të gjithë dakord me procesverbalin.

Si pikë të dytë kemi shqyrtimin në parim të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10. 03. 2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar".

Në mbledhje kemi të pranishëm propozuesin e nismës, zotin Vullnet Sinaj, deputet, kurse nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zonjën Jaku, zëvendësministre, zonjën Seferi, drejtoreshë e Programeve dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjën Eneida Çapo, përgjegjëse sektori dhe zonjën Miranda Pashaj nga Shërbimi Social Shtetëror.

Pa humbur kohë, po ia jap fjalën zotit Sinaj për të prezantuar nismën e tij.

Vullnet Sinaj – Faleminderit!

Nisma ime për amendimin e ligjit nr. 9355, datë 10. 03. 2005 erdhi si pasojë e një situatë jo shumë të mirë në bashkinë e Selenicës, pasi në muajt shtator dhe tetor pati probleme me shpërndarjen e ndihmës ekonomike.

Unë përfaqësoj atë zonë dhe pasi u interesova pse në muajt shtator dhe tetor nuk ishte shpërndarë ndihma ekonomike, u informova nga drejtoresha e Shërbimit Social Rajonal të Vlorës që kjo kishte ndodhur për arsye se nuk ishte mbledhur Këshilli Bashkiak i Selenicës dhe nuk ishte marrë një vendim që t'i dërgonte Shërbimit Social Rajonal të Vlorës listën e aplikantëve.

E kam marrë këtë nismë duke u nisur nga parimi që ne nuk mund t'i lëmë këta njerëz dhe këto familje në nevojë, për të cilët ndihma ekonomike është shumë e rëndësishme, të jenë pre e vendimeve, mbledhjeve apo mosmbledhjeve të këshillave bashkiakë, që mund të ndodhin për arsye të keqdrejtimit apo arsye politike. Varfëria nuk mund të ushqehet me politikë, por ajo ka nevojë që ta përfitojë atë që i jep ligji.

Duke u nisur nga nismat e qeverisë "Rama" dhe vetë Kryeministrit, nga puna e madhe që është bërë, ju jeni të gjithë të vetëdijshëm për financimin e Bankës Botërore për Regjistrin Elektronik Kombëtar. Me ligjin nr. 44 të vitit 2016 të drejtën për të vendosur vlerën e ndihmës ekonomike apo se kush do ta përfitojë nuk e kanë më bashkitë dhe këshillat bashkiakë, por

Shërbimi Social. Edhe pse ka ndryshuar ligji, kemi përsëri një varësi të Shërbimit Social nga këshillat bashkiakë. Kjo është e papranueshme dhe më detyroi që të lexoja ligjin, të shikoja ndryshimet dhe të vija këtu me propozime për amendim të këtij ligji.

Mendoj se këtë problem krijon neni 29, pika 1 e këtij ligji, i cili i jep të drejtën këshillit bashkiak që të marr vendim për propozim që familja apo individ në nevojë të trajtohet me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit. Ky vendim i përcillet menjëherë zyrës së strukturës rajonale të shërbimit social. Pra, unë propozoj që kjo të shfuqizohet, sepse nuk ka më kuptim. Në kushtet konkrete se si zhvillohet procedura e marrjes së ndihmës ekonomike, ka rënë poshtë vendimi i këshillit bashkiak. Në praktikë ndodh që punonjësi i administratës në njësinë administrative ndihmon personat e ndryshëm që kanë nevojë për regjistrim në regjistrin elektronik.

Tashmë ka nevojë vetëm për një listë përcjellëse, që duhet t'i shkojë Shërbimit Social Rajonal dhe jo për një vendim të këshillit bashkiak. Prandaj, propozoj që të hiqet ky nen dhe t'ia lehtësojmë punën shërbimit social. Unë kam propozuar që informacionin në këtë rast mund ta marrin nga struktura e bashkisë që përgjigjet për shërbimin social. Pra, çdo bashki ka një strukturë të vetën që përgjigjet për ndihmën ekonomike. Nuk ka nevojë të vijmë në Shërbimin Social Rajonal me propozim apo vendim të këshillit bashkiak, por të kësaj strukture.

Në këtë mënyrë mendoj që ia lehtësojmë punën Shërbimit Social, por njëkohësisht i vijmë në ndihmë njerëzve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike.

Për sa i përket rrëzimit të nenit 29, ky nen prek edhe disa nene të tjerë, si neni 27, pika 1, ku i kushtëzon strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të marrin verifikimin e të dhënave të regjistruara nga administratori shoqëror në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse të familjarëve, individëve, të cilët janë propozuar me vendim të këshillit bashkiak që të trajtohen me ndihmë ekonomike. Në këtë rast unë dua të ndryshoj shprehja “që janë propozuar me vendim të këshillit bashkiak që të trajtohen me ndihmë ekonomike” dhe të zëvendësohet me “të cilët janë përcjellë nga struktura përgjegjëse e Shërbimit Social”. Pra, të mos kemi më përcjellje të listës me vendim të këshillit bashkiak, por me një shkresë përcjellëse të njësisë përgjegjëse në bashki. Kjo mund të bëhet edhe me një dokument të kryetarit të bashkisë, pa pasur nevojë të mblidhet këshilli bashkiak.

Në të njëjtën kohë preket edhe neni 30, pika 1, që detyron strukturat përgjegjëse të Shërbimit Social në bashki të hartojnë projektvendim për familjet dhe individët në nevojë nën juridiksionin e bashkisë për trajtimin me ndihmë ekonomike për llogaritjen e fondit të mbulimit të tyre.

Në këtë rast struktura përgjegjëse nuk do të bëjë më hartim të projektvendimit, por propozoj që të bëhet “përcjell në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social të dhënat e gjeneruara nga administratori shoqëror për familjet dhe individët në nevojë, që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike”. Në këtë mënyrë thjeshtohet fare.

Pikën 2 të nenit 30 mendoj ta shfuqizojmë fare, sepse thotë që struktura përgjegjëse e Shërbimit Social në bashki paraqet në këshillin bashkiak projektvendimin për propozimin për familjet dhe individët në nevojë. Nuk ka më çfarë të paraqesë në këshillin bashkiak. E njëjta gjë është edhe me pikën 31, ku administratorin shoqëror e detyron të bëjë një propozim për këto familje, ndërkohë që kjo ka rënë. Bashkë me këto, mendoj që më vonë do të ketë nevojë edhe për ndryshimin e vendimit nr. 955, datë 17. 12. 2016 të Këshillit të Ministrave, ku në pikat 6 dhe 7 i referohet vendimit të këshillit bashkiak për listën që do të shkojë në shërbimin social rajonal.

Pra, e gjithë kjo kërkesë imja ishte për t’jua lehtësuar jetën, hallet dhe vuajtjet këtyre familjeve, të cilat nuk mund të presin këtë vendim të këshillit bashkiak, por të jetë thjesht një shkresë përcjellëse nga bashkia drejt shërbimit social. Kjo meqenëse ligji i fundit i ndryshuar thotë që në këtë rast ndihmën ekonomike e jep Shërbimi Shtetëror Social.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Zoti Sinaj, shumë faleminderit për nismën që synon të përmirësojë ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe pak a shumë të rregullojë disa pjesë të sistemit për t’u ardhur në ndihmë njerëzve! Ky është qëllimi në fund të fundit.

Megjithatë, në bisedën paraprake që patëm me përfaqësuesit e ministrisë, na vunë në dijeni që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka parashikuar ndryshime të po këtij ligji dhe një përmirësim të shërbimit.

Fjalën e ka zëvendësministrja për ta prezantuar dhe për të parë mundësitë se si mund t’i vëmë bashkë këto të dyja.

Ardiana Jaku – Shumë faleminderit!

Shumë faleminderit deputet për nismën e marrë!

Në fakt, me urdhër nr. 752 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, këtë vit ne kemi marrë nismën që të formulojnë tërësisht ligjin për mbrojtjen shoqërore. Nisur nga fakti që ligji për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore nr. 9355 ishte amenduar shtatë herë dhe kishte humbur e gjithë rrjedha logjike, ne menduam të paraqesim një ligj të ri për mbrojtjen sociale në Republikën e Shqipërisë. Janë tre programe sociale që paraqiten në këtë ligj dhe që përshkruhen në këtë kuadër ligjor: programi për ndihmën ekonomike, programi i

pagesave të aftësisë së kufizuar dhe shpërblimi për bebet, që është një politikë e re e lançuar këtë vit nga Kryeministri.

Në fakt, e gjithë kjo iniciativë e marrë nga deputeti është reflektuar më konkretisht në nenin 20 të projektligjit “Për mbrojtjen sociale”, ku parashikohet roli i këshillit bashkiak. E gjithë çfarë deputeti propozon është e reflektuar në këtë nen. Më pas lidhet edhe me reflektimet dhe me përgjegjësinë që do të kenë strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki apo administratorët shoqërorë në njësitë administrative.

Elisa Spiropali – Konkretisht, mund ta lexoni si është reflektuar?

Ardiana Jaku – Neni 20, roli i këshillit bashkiak. “Këshilli i Bashkisë miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të bërë nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike deri në 6%, duke përfshirë ose jo edhe fondet e buxhetit vendor, sipas përcaktimeve që do të bëhen nga ministri përgjegjës për Çështjet Sociale”. Do të thotë që Këshilli Bashkiak do të ketë detyrimin dhe përgjegjësinë për të marrë vendim për ato familje që nuk janë shpallur fituese nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike, por që janë aplikuese, pra, vetëm për fondin 6%, që bashkitë do të kenë në dispozicion të alokuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky do të jetë roli i tyre. Pra, në këtë rast është shmangur kalimi i listës së familjeve aplikuese për ndihmë ekonomike në bashkitë përkatëse, duke qenë se ky ishte një proces që vetëm vononte procesin e vendimmarrjes për familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe nuk ndikonte aspak në përcaktimin apo jo të vendimmarrjes për familjet që do të marrin ndihmë ekonomike. Aktualisht jemi në fazën që po e konsultojmë projektligjin, i cili shpallur edhe në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale.

Elisa Spiropali – Kur e keni parashikuar ta sillni në komision?

Ardiana Jaku – Ne kemi parashikuar që brenda muajit dhjetor ky ligj të jetë në tavolinat tuaja për ta shikuar dhe për të marrë një vendim.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Dakord.

Po, zotoi Sinaj! Është reflektuar propozimi juaj në projektligjin e ri?

Vullnet Sinaj – Në fakt, nga ajo që dëgjova këtu duket sikur nuk është reflektuar, sepse unë kam kapur një pikë që është më përpara sesa ajo që thotë ministria. Projektligji i ministrisë thotë që i ka kushtëzuar të drejtat këshillit bashkiak për 6%-in, por këtu bëhet fjalë për listën që i duhet përcjellë Shërbimit Social Shtetëror. Kush e ka të drejtën nga bashkia që t’ia përcjellë këtë listë Shërbimit Social Shtetëror. Në ligjin ekzistues, në nenin 29, që unë

kërkoj të rrëzohet, është e përcaktuar që duhet ta çojë këshilli bashkiak. Unë mendoj që këshilli bashkiak nuk ka çfarë mendimi të marrë, kur aplikimet bëhen te administratori shtetëror. Ata bëjnë vetëm përcjelljen e listës te shërbimi social dhe është shërbimi social ai që nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar bën vlerësimin kujt i takon dhe sa i takon kjo ndihmë. Pra, është diçka tjetër kjo që unë kërkoj dhe diçka tjetër ajo që ka parashikuar ministria.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Po, zoti Belba.

Nuri Belba – Për të sqaruar atë që tha Vullneti, unë di që administratorët shoqërorë pranë bashkive bëjnë vetëm aplikimin në sistem. Shërbimi Kombëtar Rajonal përpilon borderotë sa njerëz dhe familje kanë përfituar. Kjo u dërgohet këshillave bashkiake për ta miratuar në bllok sa ka shkuar muaji. Plus kësaj, ka një tjetër shumë, e cila është 6% e të gjithë totalit, që e ndan këshilli i bashkisë.

Pra, një listë shkon te Shërbimi Kombëtar me 800 familje dhe ngelet një grant i vogël në shumë të konsiderueshme që ndahet nga këshilli. Këshilli Bashkiak ndan vetëm këtë 6%, jo fond tjetër. Zëvendësministria thotë që në ligjin e ri është parashikuar që këshilli të ketë vetëm të drejtën e 6%-it dhe jo që familjet të shkojnë edhe njëherë te këshilli. U mbledh apo jo këshilli të ngelen ...

Fondi që vjen nga Shërbimi Kombëtar do të ndahet sipas borderove të gjeneruara nga sistemi. Kështu e kuptova unë.

Elisa Spiropali – Po, por ka edhe një pikë tjetër, zoti Sinaj, që thotë: “Cili është institucioni brenda bashkisë, i cili përcjell listën?”

Nuri Belba – Të kuptoj.

Nuk e përcjell institucioni, por futen aplikantët në sistem. Sistemi gjenerohet automatikisht.

Elisa Spiropali – Aktualisht e përcjell, apo jo?

Nuri Belba – Sistemi gjenerohet automatikisht dhe Shërbimi Kombëtar gjeneron sistemin, që merr listën e përfituesve dhe thotë: “Kaq janë refuzuar, kaq kanë përfituar”. Sjell te bashkia edhe listën e përfituesve, edhe listën që ka refuzuar. Kështu që me ligjin e ri...

Elisa Spiropali – Edhe një herë, patjetër që e bën sistemi, por ka mbetur një procedurë burokratike, që në fund e firmos këshilli për ta përcjellë.

Nuri Belba – Këshilli bën vetëm vendimin e fundit, që kalon shumën totale.

Elisa Spiropali – Zoti Sinaj thotë që mos ta firmosë këshilli, por të kalojë tek institucioni ose drejtoria brenda bashkisë, që merret me çështjet sociale, ose te kryetari i bashkisë, pra të mos kalojë nëpërmjet mbledhjes së këshillit.

Ilir Pendavinji - Për procedurë...

Elisa Spiropali – Zoti Pendavinji dhe më pas zonja Bode.

Ilir Pendavinji – Në fakt, do të bëj një ndërhyrje, mbase është e padrejtë, por unë gjykoj se meqenëse po diskutojmë këtë ligj dhe zëvendësministrja e Shëndetësisë thotë se ligji i ri do të vijë brenda muajit, diskutimi në terma teknikë dhe nën për nën çdo pikë do të kalojë atje. Mbase është momenti që kur të vijë ligji ta diskutojmë brenda muajit dhe jo të hyjmë në terma teknikë dhe të diskutojmë, kur shumë shpejt do ta kemi nëpër tavolinat tona, me sa kuptova.

Shqetësimi i Vullnetit është shumë i drejtë. Kështu e gjykoj unë. Mbase nuk është e shprehur qartë, por Vullneti do që, brenda ligjit të Ministrisë së Shëndetësisë, të fusë edhe propozimin e tij, i cili besoj se do të jetë shumë i vlefshëm, sepse, me sa po kuptoj, është...

Elisa Spiropali – E vetmja arsye pse po e diskutojmë është që të marrim një vendim a do ta votojmë sot projektligjin e zotit Sinaj apo do të presim projektligjin e ministrisë? Është e rëndësishme ta vendosim këtë. Po e ndihmojmë ministrinë që ndoshta të marrë edhe një kontribut tjetër nga projektligji, sepse nuk më duket se përputhen, pra janë dy gjëra të ndryshme. Duhet të marrim vendimin nëse do ta votojmë sot apo do të presim që brenda muajit ministria të sjellë projektligjin.

Klodiana Spahiu - Përshëndetje të gjithëve!

Së pari, doja të falënderoja deputetin, kolegun tonë të nderuar për nismën që ka ndërmarrë, pavarësisht se paralelisht me këtë është punuar edhe nga qeveria për të sjellë një projektligj të ri social, i cili është më i gjerë dhe ka tematika shumë më të gjëra se vetëm ato ku është fokusuar deputeti!

Këto lloj nismash, në fakt, janë shumë pozitive, sepse tregojnë edhe një herë se sa pranë qytetarëve jemi dhe sa e ndjejmë përgjegjësinë për t'i qenë pranë kur ata kanë nevojë.

Është e vërtetë ajo që tha edhe deputeti, që ndihma ekonomike nuk është ajo që mban familjen, por për ato familje ajo është shumë e rëndësishme.

Për rastin konkret (kemi pasur një rast të ngjashëm në legjislaturën e kaluar) mendoj që ne nuk votojmë dot, por nëse deputeti e shikon të arsyeshme që kjo do të jetë e përfshirë në projektligjin që do të vijë nga ministria, duhet të tërhiqet deputeti me nismën e tij. Kështu që nëse bie dakord deputeti, së bashku me variantin që do të vijë nga qeveria, atëherë ne nuk votojmë, por deputeti, nëse mendon se përfshihet...

Elisa Spiropali – Prandaj na shërben edhe sqarimi që deputeti të marrë një vendim dhe të procedojmë.

Po, zonja Bode, pastaj zonja zëvendësministre.

Edlira Bode – Me çfarë kuptova (edhe unë bashkohem me Vullnetin), nga sqarimi që na dha zëvendësministria nuk doli i qartë roli i këshillit bashkiak në momentin e kalimit të listës mbas pikëzimit, listës që gjenerohet nga sistemi. Kalimin e saj për t’u bërë efektivisht dhënia, gjenerimi i të ardhurave, aktualisht, e bën këshilli bashkiak. Në atë që thoni ju, nuk doli e qartë nëse do ta bëjë prapë apo jo, sepse ju folët vetëm që këshilli bashkiak do të merret me shtesat, me 6-përqindëshin, por se çfarë do të bëjë me listën nuk na e thatë.

Nëse te ligji juaj është e qartë që tani, që nuk ka më rol këshilli bashkiak, ne jemi në rregull. Besoj se edhe Vullneti do të jetë i qartë. Në qoftë se jo, mendojeni ta përshini ose jo këtë si fakt. Na e lexoni te ligji ku shkruhet se lista që gjenerohet nga sistemi nuk kalon më te këshilli bashkiak, por automatikisht bëhet pagesa. Kaq.

Faleminderit!

Adriana Jaku – Në fakt, unë citova rolin që do të ketë këshilli bashkiak vetëm për 6-përqindëshin. Aktualisht, këshilli bashkiak merr vendimin për projektvendimin për familjet aplikuese, një vendim, i cili vononte në kohë marrjen e vendimit më pas nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror për familjet përfituese. Pra, procesi ka një hallkë, ku përfshihen këshillat bashkiakë për marrjen e një vendimi vetëm për familjet aplikuese, pra jo vendimin për familjet përfituese.

Atë që thotë deputeti te neni 29 i ligjit ekzistues: “Merr vendimin për propozimin, që familja dhe individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit”, tashmë i ka kaluar si funksion Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

Ajo çfarë kemi specifikuar ne në ligjin e ri “Për mbrojtjen sociale” është fakti që këshillat bashkiakë do të kenë përgjegjësi vetëm për ndarjen e fondit 6% apo fondeve të tjera nga buxheti i tyre vendor.

Elisa Spiropali – Ndonjë çështje të fundit?

Vullnet Sinaj – Nismën e mora pa e ditur që ministria ishte duke bërë propozime për ndryshimin e ligjit.

Do t’i thosha zëvendësministres se ju mund ta bëni ndryshimin, por, pa e rrezuar nenin 29, përsëri do të kemi probleme. Mbase kemi nevojë të bashkëpunojmë, për të lehtësuar jetën e atyre njerëzve që kanë nevojë. Nuk kam asnjë qëllim tjetër. Qëllimi im ishte për t’u ardhur në ndihmë jo vetëm banorëve të bashkisë sime. Pavarësisht se me ndërhyrjen e drejtoreshës rajonale, të drejtorisë së përgjithshme, ministres së Shëndetësisë problemi u zgjidh dhe ata nuk e humbën, nuk mund t’i lëmë njerëzit në varësi të vendimmarrjeve të ndryshme kur ata i mbron ligji.

Si deputet, mendova që duhet të ndikonim drejtpërdrejt në ligj dhe të mos mbeteshim më peng i këtyre vendimmarrjeve, mbledhet ose jo këshilli bashkiak, ndërhyr apo nuk ndërhyr drejtoresha...

Prandaj, edhe një herë, neni 29 duhet të rrëzohet, sepse do të krijojë përsëri probleme në të ardhmen.

Unë bashkohem me mendimin tuaj dhe për mua nuk ka asnjë problem për amendimin që kërkoj. E rëndësishme është të bëjmë një ligj ashtu siç duhet, sepse di që brenda këtij ligji kemi edhe probleme të tjera dhe ne duhet të mendojmë për asistencën e personave me aftësi të kufizuara, të cilët kanë humbur aftësinë për të punuar dhe në 5-vjeçarit e fundit nuk kanë qenë të siguruar një vit nga këta 5 vjet apo edhe norma të tjera, që, me $\frac{3}{4}$ -tat e moshës, diferenca nga 50 në 20, që ata duhet të kenë qenë të siguruar, është e lartë. Kështu që ka edhe probleme të tjera.

Gjej rastin t'ju them se me ndryshimet që do të bëni për ndihmën ekonomike të këtyre familjeve në nevojë, brenda këtij ligji të shikoni mundësinë për të parë ndryshimet që duhet të përfitojnë ata njerëz, të paktën për ato vite që kanë punuar, sepse janë të penalizuar. Nga njëra anë, nga ky ligj dhe nga kjo skemë kemi përfitues ata që nuk kanë punuar asnjë ditë dhe, nga ana tjetër, ka njerëz të tjerë që janë dëmtuar, që kanë pasur vite të tëra pune dhe nuk përfitojnë. Meqenëse do ta ndryshoni, mund të ndryshoni edhe këtë pjesë.

Unë, si deputet, nuk kam asnjë problem, por e rëndësishme është të zgjidhet halli i atyre njerëzve në nevojë.

E mendova dhe përderisa kishte ndodhur në bashkinë e Selenicës, mund të ndodhte edhe në një bashki tjetër. Nuk është problemi i një zone të caktuar, por mund të jetë problem edhe Tirana apo gjithë bashkitë e tjera.

Faleminderit që më dëgjuat!

Shpresoj që ministria ta bëjë sa më shpejt këtë ligj, sepse mund të ketë edhe probleme të tjera.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu - Meqenëse këtu kemi ministren, kemi përfaqësues nga shërbimi social, por kemi edhe Denadën, me të cilën ne kemi diskutuar prej shumë vitesh, dua t'ju pyes: problemi që ngriti deputeti, a do të marrë ndonjë zgjidhje me ligjin e ri? Domethënë, ata njerëz që kanë një lloj vjetërsie pune, a do t'i nënshtrohen një mbrojtjeje sociale?

Kishte një periudhë kohe kur arritën të merrnin diçka si mbrojtje sociale, pa përfituar nga sigurimet shoqërore.

A do të jetë e mundur në këtë ligj të ri që të përfshihen edhe këta njerëz, që nuk kanë një vit siguracione në 5 vjetët e fundit dhe kanë x vite vjetërsi pune?

(Diskutime pa mikrofon.)

Denada Seferi - ... të siguruar apo jo, te pjesa jonë, e cila mbulon aftësinë e kufizuar. Pra, e gjithë pjesa e aftësisë së kufizuar, jo për shkak të punësimit, do të jetë pjesë e një ligji të ri për përfitimin e aftësisë së kufizuar. Ndoshta kjo është një politikë e re, e cila do të shpallet nga ministria dhe do të vijohet më tej edhe me pjesën e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, këta që kanë problematikën, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Pjesa që mbulon Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për personat me aftësi të kufizuar e bërë e tillë gjatë periudhës së jetës së tyre, jo për shkak të punësimit.

Klodiana Spahiu – Atëherë, kjo problematikë që thatë ju është më vete, kurse problematika që ngriti deputeti dhe të gjithë jemi të interesuar ta dimë, bën fjalë për...

Denada Seferi – Nuk është pjesë e këtij ligji.

Klodiana Spahiu – E kuptoj shumë mirë që nuk është pjesë e këtij ligji, por a do të ketë një zgjidhje përfundimtare? Apo ne nuk do të arrijmë dot që këtyre njerëzve t'u ofrojmë një lloj mbështetjeje në rastin kur nuk e kanë këtë vitin e siguracionit në 5 vjetët e fundit?

Denada Seferi – Në fakt, ne jemi në negociata me Ministrinë e Financave, sepse ajo i mbulon tani dhe jemi në vazhdimësi në diskutime për mënyrën e zgjidhjes pikërisht për këtë arsye dhe për këta persona, të cilët nuk janë të siguruar një vit në 5 vjetët e fundit.

Elisa Spiropali – Është shumë e rëndësishme që ajo të zgjidhet dhe në rast se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, nuk i jep një zgjidhje brenda muajit dhjetor, e kemi diskutuar me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe do të paraqesim një nismë për zgjidhjen e kësaj problematike, sepse është diskriminim i pastër. Pra, një njeri që ka lindur me aftësi të kufizuara apo një njeri që nuk është i siguruar një vit në 5 vjet nuk e përfiton, ndërkohë ai është i paaftë për punë. Kjo nuk kuptim dhe nuk bën sens.

Unë e kam diskutuar edhe me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë, duke u nisur nga shqetësimi që kanë deputetët e këtij komisioni. Ne do ta paraqesim në komisione dhe në seancë si nismë deputetësh.

Është shumë mirë që si ministri keni menduar t'ia nisni Ministrisë së Financave. Kjo çështje duhet zgjidhur. Këta persona kanë vite të tëra që vuajnë nga mungesa e punës për shkak të aftësive të tyre të kufizuara dhe nuk marrin as mbrojtje sociale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka edhe njerëz që kanë vite punë, por që u takon për shkak të aftësisë së kufizuar.

E falënderoj shumë edhe deputetin!

Nga diskutimi këtu doli që ministria e ka parashikuar ndryshimin në këtë ligj dhe ka bërë një ligj më tërësor për të gjithë mbrojtjen sociale.

Nëse deputeti ka ndonjë çështje të fundit, do të ishte mirë që së bashku me ministrinë ta diskutojë për ta ndryshuar para ardhjes së projektligjit tuaj në komisionin tonë, në mënyrë që edhe ajo që propozon deputeti, të cilën ne e gjykojmë si shumë të arsyeshme dhe të drejtë, të përfshihet në projektligjin tuaj.

Në këtë mënyrë, ne nuk do të votojmë sot, por do të presim brenda muajit, siç u premtua, duke qenë se këta njerëz nuk mund të presin, sepse kjo është një çështje që shkurton angaritetë burokratike nga të cilat këta njerëz vuajnë shumë. Përderisa këta njerëz janë aty për të marrë një ndihmë të tillë, që është modeste, nuk mund të presin hallkat tona burokratike nëpër këshilla. Ne e dimë si funksionojnë këshillat bashkiakë. Ne do të presim që të sillni brenda muajit projektligjin tuaj dhe më pas do ta votojnë në tërësi në komision.

Faleminderit për nismën!

Do të shihemi në dëgjuesën e radhës.

Presim nga ministria të caktojë datën për dëgjuesën për modernizimin skemës së ndihmës ekonomike. Ne kemi lënë një dëgjuesë në këtë komision brenda vitit për këtë çështje, për mënyrën se si ka shkuar përhapja e ndihmës së re ekonomike në të gjithë territorin dhe si po funksionon shpërndarja e ndihmës ekonomike.

Faleminderit dhe gjithë të mirat!

MBYLLET MBLEDHJA